# Konkurs për raportin më të mirë të mediave për integrimin europian në Serbinë juglindore dhe jugperëndimore

## 1. Informacionet kryesore

PROGRES-i Europian është Program shumë-donatorësh të cilin e finansojnë unioni Europian (EU), Qeveria Zvicerane dhe Qeveria e Republikës së Serbisë (RS), e qëllimi është që të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të Serbisë juglindore dhe jugperëndimore. Koncepti i Programit është ideuar në bashkëpunim me Zyren për integrime europiane të Republikës së Serbisë (KEI), e cila është kompetente për përcjelljen e implementimit, si edhe ofrimin e ndihmës dhe lehtësimin e punës. Për implementimin e Programit është e ngarkuar Zyra e kombeve të bashkuara për shërbime të projekteve (UNOPS), të cilës i është miratuar buxheti fillestar prej 17,46 milionë euro.

Ky program me qasje shumë sektorëshe do të kontribojë në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të pazhvilluara dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për përmirësimin e infrastrukturës dhe kushtet e punësimit duke forcuar qeverisjen lokale, përmirësimin e koordinimit vertikal, kapacitetet për planifikim dhe menaxhim, përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe zhvillimit, si dhe përparimin dhe realizimin e politikave inkuadruese sociale dhe të punësimit.

Në kuadër të Programit punohet për arritjen e katër rezultateve në vazhdim, në të cilën parimet e qeverisjes së mirë janë aspekti transversal që përshkon të gjithë ndërhyrjen:

1. Forcimin e qeverisjes lokale, kapacitete për planifikim dhe menaxhim nëpërmjet futjes së procedurave të reja ose përmirësimin/eleminimin e procedurave dhe proceseve ekzistuese në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë.

2. Rritjen e konkurencës së ekonomisë vendore duke përmirësuar mjedisin e biznesit dhe të menaxhimit/kapacitetet organizative të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme/kooperativat bujqësore.

3. Përmirësimin e qasjes në punësim ku i ofrohet mundësi të barabarta edhe burrave dhe grave, si edhe përfshirjen sociale të grupeve më të rrezikuara dhe margjinalizimin e grupit përmes formulimit dhe zbatimit të politikës lokale në mënyrë që të zvoglohet migrimi nga Serbia jugperëndimore dhe juglindore;

4. Njoftimin e publikut të gjërë nga efektet e anëtarësimit të Serbisë në bashkimin Europian.

Përfituesit përfundimtarë të këtij Programi, por njëherit edhe akterët e saj kryesorë dhe bashkë-finansuesit, bëjnë pjesë në 34 qeverisjet lokale të mëposhtme nga grupi i tretë dhe i katërt i shkallës së zhvillimit, të cilat janë të detyruara të marrin “pronësinë“gjatë aktiviteteve që zbatohen në territorin e tyre:

- Novi Pazar, Rashka dhe Tutini në rrethin e Rashkës
- Nova Varosh, Priboj, Prijepolje, Sjenica në rrethin e Zlatiborit
- Ivanjica në rrethin e Moravicës
- Prokuplje, Blace, Zhitoragja, Kurshumlija në rrethin e Toplikut
- Leskoci, Bojniku, Vllasina, Lebani, Medvegja dhe Crna Trava në rrethin e jablanicës
- Vranja, Bosilegradi, Bujanoci, Vladiçin Han, Presheva, Surdulica dhe Trgovishta në rrethin e Pçinjës
- Brus në rrethin e Rasinjës
- Aleksinci, Gadzhin Hani, Doljevaci, Meroshina dhe Svrljigi në rrethin e Nishavës
- Babushnica dhe Bela Palanka në rrethin e Pirotit
- Knjazhevci në rrethin e Zajeçarit

Shfrytëzuesit e tjerë përfshijnë, ndër të tjera, institucionet e themeluara nga komunat dhe kompanitë e shërbimeve publike, organizatat e shoqërisë civile (OShC) dhe mediat në pushtetin vendor që marrin pjesë në Program. Përfituesit më të mëdhenj të programit do të jenë saktësisht qytetarët e Serbisë juglindore dhe jugperëndimore.

Aktivitetet e komunikimit janë një element thelbësor i përpjekjeve të përgjithshme që bëhen për të arritur objektivin kryesor të PROGRES-it Europian - për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të pazhvilluara dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve të punësimit. Mediat në strategjinë e komunikimit të PROGRES-it Europian përcaktohen si përhapës të rëndësishëm të informacionit dhe janë thelbësore për transmetimin e saktë të mesazheve në zhvillimin e grupeve të synuara.

## 2. Hyrje

Mediat si burim kryesorë i informacioneve luajnë rrol kyç në informimin e qytetarëve të Republikës së Serbisë në lidhje me procesin e integrimeve europiane dhe përfitimet që ata do ti kenë.Kjo veçanërisht vlenë për mediat lokale, të cilat mund të japin informacion të duhur, të saktë dhe në kohë në lidhje me aspektet e integrimit me rëndësi për komunitetin lokal, dhe kështu i shpartallojnë paragjykimet e zakonshme dhe mitet në lidhje me atë proces.Qytetarët dhe qytetaret, megjithatë, nuk kanë asnjë ose kanë qasje të limituar (kufizuar) në informacione në lidhje me efektet që do të kenë në jetën e tyre të përditshme pas anëtarësimit në BE.Përveç kësaj në qëndrimet e tyre ndikim të madh kanë temat politike. Prandaj është e rëndësishme që aspektet e zhvillimit të aderimit dhe anëtarësimit në BE në përmasat më të mëdha të ndahen nga politika.

Hulumtimi i opinionit publik i kryer në tetor të vitit 2015 tregoi se më shumë se 45% e qytetarëve mendojnë se jo mjaftueshëm janë të informuar në lidhje me BE-në. Analiza e detajuar e rezultateve të këtij hulumtimi tregon kuptim të kufizuar të aspekteve kryesore të procesit të integrimit evropian - një e treta e popullsisë ka frikë se anëtarësimi në BE do të çojë në rritjen e varfërisë dhe të papunësisë, 18% e tyre do të kontribojë në një humbje të identitetit dhe sovranitetit kombëtar, dhe 16% që do të çojë në shfrytëzimin e burimeve

kombëtare, ndërsa 15% e qytetarëve shfaqin pakënaqësi ndaj BE-së sepse i bëhet presion Serbisë për të njohur pavarësinë e Kosovës [*].

Sipas anketës, pothuajse një e treta e qytetarëve (29%) besojnë se mediat janë ato që duhet të informojnë në lidhje me efektet e anëtarësimit të Serbisë në BE. Qytetarët do të donin që të të informoheshin në lidhje me - politikën rinore, politikën sociale, ekonominë e BE-së në përgjithësi, politikën në fushën e arsimit, mbrojtjen e konsumatoreve, burimet financiare të ndara për të mbështetur vendet kandidate dhe mbrojtjen e mjedisit dhe bujqësisë. [2] Si më të popullarizuara janë shfaqur histori për përvojat e njerëzve të zakonshëm në procesin e bashkimit dhe tregime të shkurtra me lajme mbi tema të rëndësishme, si dhe mendimet e ekspertëve dhe të informacionit dhe programet televizive arsimore të specializuara dhe raporte në lidhje me ngjarjet aktuale.[3]

PROGRESI Europian për këtë e shpallë këtë Konkurs dedikuar mediave, në partneritet me Delegacionin e unionit Europian në Republikën e Serbisë (UDE), dhe Zyrën për integrime europiane të Qeverisë së Republikës së Serbisë (ZIE) me qëllim të promovimit të raportimit kualitativ medial dhe profesional për temat e cekura dhe rritjes së njohurisë së përgjithshme dhe mirëkuptimit në publik për integrimet europiane dhe ndryshimet pozitive të cilat mund ti sjellin në jetën e përditshme banorëve të 34 vetëqeverisjeve lokale në të cilat programi realizohet.

## 3. Temat e garimit

Progresi Europian, Delegacioni i BE dhe Zyra për integrime europiane ftojnë të gjitha mediat të cilat i përmbushin kushtet e pjesmarrjes dhe gazetarët të cilët punojnë për ta të ofrojnë propozime të shkruara, elektronike (TV dhe radio) dhe onlajn-drejtpërdrejt, internet për proceset e integrimeve europiane dhe efektin e tij në jetën e përditshme të banorëve lokal, si dhe përkrahjen të cilën BE dhe Qeveria Zvicerrane i ofrojnë zhvillimin e vetëqeverisjeve lokale të përfshira me Program.

Propozimet mediale të cilët i plotësojnë kushtet e pjesëmarrjes duhet jenë të rregulluara në temat relevante të cilat e interesojnë publikun, e të cilat kanë të bëjnë me integrimet europiane dhe përkrahjen e përgjithshme të cilën BE ofron në lokal ashtu që të përmirësohet gjendja ekonomike dhe shoqërore në bashkësi – gjegjësisht në përkrahjen: rritjen ekonomike, udhëheqjen e mirë, përosshmërinë e kualitetit të jetës në lëmin e arsimit, shëndetësisë,kulturës,jetën e të rinjëve, mbrojtjen e mjedisit jetësor, inkuadrimin e kategorive të popullatës dhe përparimin e barazisë gjinore.

Mediat të cilat paraqiten në konkurs rreptësisht mund të paraqesin propozimet në formën e shkruar, elektronike (TV dhe radio) dhe formatin onlajn-drejtpërdrejt të cilat janë përgatitur dhe për herë të parë janë të paraqitura/emituar në periudhën prej 15. Dhjetor 2016 deri 1 mars 2017.

---

[*] Ky emërtim nuk vë në pyetje qëndrimet në lidhje me statusin dhe është në përputhje me rezolutën SBUN 1244/99 dhe Opinionin e MPJ për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

**Shpërblimet për propozimet në e shkruara, elektronike (TV dhe radio) dhe onljan, internet formatin do të jenë të ndara në tetë kategoritë vijuese:**

1. Paraqitja më e mirë në TV (stacionet televizive, agjencionet gazetare)
2. Paraqitja më e mirë në radio (radio stacioni)
3. Paraqitja më e mirë e shtypur (gazetat ditore periodike)
4. Paraqiitja më e mirë e mediave të pavarura elektronike të shtypura (forma redaktuese faqja e internetit ose internet portalit)
5. Seria më e mirë e paraqitjes mediale (inkuadruar të gjitha llojet e mediave – TV, radio, mediat e shtypura, internet mediat e paraqitura)
6. Paraqitja më e mirë për ndërrmarrësinë, duke inkuadruar edhe ndërrmarrësin e të rinjëve, grave, ndërrmarrjet e vogla dhe të mesme, grupet prodhuese të bujqëve dhe partneritetin mes vetëqeverisjeve lokale dhe organizatave të shoqërisë civlile
7. Paraqitja më e mirë për projektin të cilin e ka financuar ose momentalisht e financon BE dhe i cili është realizuar apo monetalisht është duke u realizuar në Fushën e përgjegjësisë (PO) PROGRES-it Europian gjegjësishtë në 34 Vetëqeverisje lokale të përrfshira me Program
8. Paraqitja më e mirë pëpr projektet potenciale në Selin e PROGRES-it Europian të cilat do të kontribonin përmirsimin e kualitetit të jetës të bashkive lokale.

## 4. Shpërblimet

Shpërblimet do tu jepen mediave ose gazetarëve dhe gazetareve të cilat punojnë për ta, të cilat janë autore/ e të paraqitjeve më të mira për integrimet europiane në juglindje dhe jugperëndim të Serbisë.

Unioni Europin dhe Qeveria Zvicerane me ndërmjetsimin e PROGRES-it Europian do ti shpërblejë me një dhuratë për paraqitjen më të mirë mediale në secilën prej tetë kategorive. Mediat të cilat do të fitojnë në garë si shpërblim audio, audio-video paisje të re, ose paisje elektronike me ose pa softverin përcjellës në vlerë prej 5.000 euro.

Mediat duhen me rastin e paraqitjes në garim të kenë edhe dokumentacionin e cekur në Aneks ashtu që të mund të përcaktohet paisja dhe specifikatat e saj dhe me këtë të sigurohet që fituesit të marrin shpërblimin i cili do të kontribojë në përmirsimin e kapaciteteve teknike të tyre.

Shpërblimet për gazetar/e që janë autor/e të punimeve të shpërblyera do ti siguroj KEI e do të inkuadroj edhe vizitën dyditore insitutcioneve relevante shtetërore të inkuadruara në procesin e integrimeve europiane në Beograd, derisa Delegacioni i unionit Europian për gazetarët e shpërblyer/do të organizoj vizitë studimore në Bruksel, ku do të takohet me kolegët të cilat raportojnë nga Brukseli.

## 5. Kushtet e pjesëmarrjes

Në këtë garë të drejt pjesëmarrjeje kanë mediat të cilat i plotësojnë kriteriumet vijuese:

- Është i regjistruar si gazet lokale ose regjionale ditore, agjencion i gazetarisë, radio program, program televiziv ose gazetë e pavarur elektronike (redaksi e paraqitur faqe e internetit ose portal i internetit) me seli në njërën nga Vetëqeverisjet lokale e përfshirë me PROGRES-in Europian

- I regjistruar si media regjionale me seli jashtë selisë së PROGRES-it Europian i cili në dy vitet e fundit ka përrfshirë raportoi për ngjarjet më më së paku në pesë Vetëqeverisje lokale të përrfshira me Programin (çka tregon me paraqitjen e kopjeve më së paoku pesë paraqitjeve elektronike të shtypura)
- I regjistruar në regjistrin e mediave të Agjensionit për regjistra ekonomik të RS, në bazën nacionale, të centralizuar të të dhënave të mediave
- Nëse bëhet fjalë për mediat elektronike, disponojnë leje për ofrimin audio mediave dhe mediave-vizuele shërbyese të cilën e jep trupi Regullativ për mediat elektronike
- Mund të paraqitet vetëm se paraqitja e shkruar, onlajn ose elektronike (TV radio) paraqitja i cili medi do të paraqitet në garim ka bërë dhe paraqitur/emituar në periudhën prej 15. Dhjetor 2016. Deri 1 mars viti 2017.
- Çdo media, gjegjësisht autor/e mund të jenë të shpërblyera për një paraqitje mediale.

## 6. Kriteriumet për zgjedhjen e paraqitjeve më të mira

Anëtarët e jurisë dë ta përbëjnë përfaqësuesit e Delegacionit Europian në Republikën e Serbisë, agjensionit Zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), Zyra për integrime europiane (KEI) dhe PROGRES-it Europian

Fituesit do të përzgjidhen në bazë të paraqitjeve relevante në krahasim me temat dhe kushtet e garimit:

- Propozimet mediale duhet jenë të përkushtuara temave të cilat kanë të bëjnë me procesin e integrimeve europiane dhe përkrahjen e unionit Europian zhvillimin e 34 Vetëqeverisjeve lokale në pjesën e programit e cila ofrohet në ndërmjetsimin e PROGRES-it Europian dhe duhet të kontriboj rritjen e ndërgjegjes publike për ta.
- Paraqitjet mediale duhet të paraqesin më shumë se raportimin e ngjarjeve të tëra, duhet të kenë formën kërkimore reportazheve dhe se qart duhet të theksojnë dhe spjegojnë dobitë të cilat vetëqeverisja lokale ka në lëmin e arsimit, shëndetësisë, kulturës, përkrahjen e të rinjëve mbrojtes së mejdist jetësor inkuadrimine grupeve të rrezikuara të popullatës, etj., si dhe zhvillimin e prëgjithshëm ekonomik dhe shoqëror i cili kontribon përmirsimin e kualitetit të jetës.
- Gjuha e cila shfrytëzohet në paraqitje nuk duhet të jetë i ngarkuar me shprehjet birokratike dhe administrative, klishetë, por e kuptimt, i cili do të ndihmoj qytetarëve të thjeshtë dhe qytetareve të kuptojnë procesin mundësive të cilat i ofrojnë.

- Paraqitjet mediale duhen ti përmbushin kriteriumet mediale, duke inkuadruar edhe kërkimet, aftësinë e shkrimit, intersin publik, etikën, origjinalitetin, inovatetin dhe kreativitetin; poashtu duhet të mirret para sysh a mundet materjali të jetë iniciator e ndryshimeve pozitive në shoqëri.

- Në pamjen e mediave elektronike:

i. Audio dhe video kontributet e paraqitura duhet të paraqesin prodhimin origjinal medial, gjegjësisht gazetarëve/e të cilat i plotësojnë kushtet e pjesmarrjes.

ii. Me shtojcat e paraqitura, ju kur është nevoja dhe e mundshme, duhet të praqiten dëshmitë për lejen shfrytëzimit të veprës së autorit, qoft që ka të bëjë me incizimet e marrura, muzikën e licencuar apo të palicencuar, etj.-paraqitjet të ofruara pa këto dëshmi nuk do të jenë të vlersuara

iii. Paraqitjet duhet kryesisht të përmbajnë materjalin origjinal të inçizuar (për dallim deri tek inçizimi të cilët mund të shfrytëzohen edhe në shtojcat tjera ose segmentet të cilat i ka inçizuar dikush tjetër, e jo media, gjegjësisht autori/drejt të cilit përmbushen kushtet e pjesmarrjes, etj.).

Fletëparaqitja e cila nuk është paraqitur në përputhshmëri me kërkesat dhe kriteret të kësaj gare, e cila është jo e plotë e paraqitur pas skadimit të afatit, do të diskualfikohet. Vendimi mbi diskualifikimin e paraqitjes është përfundimtare.

- PROGRES-i Europian/UNOPS mban të drejtën të shfrytëzoj tër materjalin për materjalet e tyre promovuese dhe aktivitetet dhe që ta reprodukojë me qëllim të promovimit të shpërblimit, si dhe vetë UNOPS-it dhe Programit.

## 7. Procedura e paraqitjes

I. Materjali medial në të cilin qart është i etiketuar autori/ja, kjo dmth. Gazetari/ja duhet të paraqes në përputhshmëri me procesin e tutjeshëm:

- **Paraqitjet e mediave të shkruara:**

Mediat e shkruara duhet të paraqesin kopjen origjinale të paraqitjes në tri kopje (nëse kjo është e mundur). Është e lejuar të paraqitet kopjen shum kualitative të shtojcës në rast se nuk egziston kopja origjinale e mostrës së paraqitur.

- **Radio shtojcat:**

Radio stacionet duhet të paraqesin shtojcat në tri kopje në CD-në ose formatin mp3. Shtojca e paraqitur duhet jetë qartë e paraqitur në etiketën e CD-së, në të cilën është emërtimi i cekur, adresa dh numri i telefonit të pjesëmarrësit/ses në kinkurs.

- **Shtojcat televizive:**

Stacionet televizive duhet të paraqesin shtojcat në tri kopje në DVD-i, ose që materjalin ta dërgojnë onlajn. Shtojca e paraqitur duhet të paraqitet në vendin qartë të etiketuar në DVD-i, në të cilat janë të paraqitura emri, adresa dhe numri i telefonit të pjesmarrësit/në konkurs.

- **Shtojcat e mediave elektronike publike të pavarura**

Publikimet e pavarura elektronike të mediave duhet të paraqesin CD me artikullin e shtypur/shtojcën në HTML, formatin ose në internet adresën në të cilën (pandryshuar) materjali mund të shiqohet.

Parashtruesit e shtojcës duhet të plotsojnë të drejtat e tyre dhe obligimet të lidhura me garimin i cili është i pranishëm në: http://www.europeanprogres.org/pozivi/sr/

II. Kur është fjala për shpërblimet e parapara për fituesit e kësaj gare, mediat të cilat në të paraqiten duhet në kovert të posaçme të paraqesin dokumentacionin përkatës në Aneksin I.

## Kujt dhe si të paraqitet fletparaqitja

Parashtruesi i fletëparaqitjes duhet të paraqesë origjinalin dhe nga një kopje të formularit të fletparaqitjes dhe materjalit medial i cili i paraqitet për garim, si dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Të gjithë pjesmarrësit/et duhet të plotësojnë formularin në gjuhën angleze në mënyrën gjegjëse. Do të konsiderohet se fletparaqitja e cila nuk përmban informacionet e kërkuara ose nuk përmban përgjegjet në pyetjet e parashtruara në formularët nuk përmbush kushtet për shqyrtimin e tutjeshëm dhe ajo do të refuzohet.

Fletparaqitjet duhet të dorzohen me postë ose personlisht të dorzuara në zyrën e PROGRES-it Europian në këtë adresë:

**UNOPS/Evropski PROGRES, Skerlićeva 4, 11000 Beograd**

**Naznaka za „Konkurs za najbolji medijski prilog”,**

Do të refuzohen fletëparaqitjet të cilat janë të dorzuara në cilën do formë tjetër (me faks ose postën elektronike) ose të dorzuara në adres tjetër.

## Afati i paraqitjes së fletparaitjes

Afati për dorzim 1. Mars 2017

PROGRES-i Europian do të organizoj takime informative për konkursin, sa i përket vendit, data dhe koha e takimit do të shpallen në faqen e internetit të Programit.

Të gjitha pyetjet me temat e garimit, kushtet dhe procedurat e paraqitjes mund të dorzohen me postë elektronike më së voni deri më 20. Shkurt 2017. në këtë adresë rspc.ep.commms.@unops.org, më qartë të theksuara se kanë të bëjnë me garimin. Organizatori pas asaj date nuk e ka obligim ti ofrojë sqarime shtesë.

Organizatori në pyetjet do ti përgjigjet më së voni shtatë ditë pas skadimit të afatit për paraqitjen e fletëparaqitjes.

Pyetjet dhe përgjigjet të cilat mund të jenë të rëndësishme edhe për pjesmarrësit tjerë dhe pjesmarrëse në konkurs do të shpallen në faqen e internetit të PROGRES-iz Europian http://www.europeanprogres.org/pozivi/sr/, ashtu që me shiqimin e rregullt e faqes gjegjëse të internetit mund të jeni të informuar me vet pyetjet e parashtruara dhe përgjejgjet e ofruara.

## 8. Dokumentacioni përcjellës

Është e nevojshme të paraqitet dokumentacioni përkatës në gjuhën serbe:

- Fotokopjen e vendimit të regjistrimit të subjektit juridik ose ndërrmarrësit në Agjension për regjistra ekonomik (ARE)
- Fotokopjen e vendimit të regjistrimit të medias në ARE
- Fotokopjen e e lejes për emitim radio dhe/ose programit TV të cilën e jep trupi Regulativ për media elektronike
- Deklarata në formën e lirë për likuiditetin e ndërrmarrjes/botuesit të medias me të cilën tregohet se llogaria bankare e të njejtit në vitin e fundit nuk ka qenë e bllokuar (prej 1 Mars 2016 – 1 Mars 2017).

- Vërtetimin e drejtorisë gjegjëse tatimore dhe vetëqeverisjes lokale se parasshtruesi i ka kryer të gjitha obligimet tatimore deri në ditën e shpalljes së thirrjes (vërtetimet nuk gucojnë të jenë më të vjetra se gjashtë muaj në momentin e paraqitjes së fletparaqitjes)-origjinal ose fotokopja e vërtetuar e vërtetimit. Publikuesit medial munden në vend të këtyre dy vërtetimeve të paraqesin dëshmin se janë të regjistruar në Regjistrin e ofertuesit të ARE. (Agjensioni për Regjistra Ekonomik).
- Mediat regjionale me seli jasht zonës së PROGRESIT Europian i cili më së paku mbulojnë dhe raportojnë për ngjarjet në më së paku pes vetëqeverisje lokale të përfshira me Program duhet të paraqes dëshmitë për më së paku pes shtojca elektronike/të shtypura në CD (kur bëhet fjalë për TV ose stacionet e radios ose mediat e shtypura) ose lidhjet e internetit (kur bëhet fjalë për publikimet e pavarura të internetit).

## 9. Aneks I

Mediat të cilat paraqiten në konkurs duhet të paraqesin informata të sakta për paisjet në vlerë deri në 5.000euro. e cila duhet të kontriboj përmirsimin e kapaciteteve teknike.

Për këtë parashtruesit e fletparaqitjes duhet të paraqesin:

- Së paku një Profaktur për blerjen e paisjes së kërkuar
- Specifikatat e detajizuara të paisjes së kërkuar